



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 7473

Nr. koleksioni: 3310

Tirane më 20/08/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2025053950367848141



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "ECW" SH.P.K)



Sot, më datë 20 Gusht 2025 (dymije e njezete e pese), perpara meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqiten personalisht:

SHITES:

Greg Xhillari, atësia Alban, amësia Rudina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Thanas Ziko P.1 Ahk.1 Ap.2; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 16/01/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032987947 dhe nr. personal J70116061L;

dhe

BLERES:

Erland Reka, atësia Sali, amësia Meliha, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Mustafa Qosja; Nd. Nd.6; H. 2; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 06/02/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034100327 dhe nr. personal H90206047V;

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- A. Shoqëria "ECW" Sh.P.K. (ne vijim "Shoqëria"), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi NUIS L91425020M, me kapital themeltar prej 5.000,00 (pese mije leke) Lekë, sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar shitesit zoteron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
- B. Shitësi i ka njoftuar Blerësin për ofertën e tij për shitjen e kuotës së zotëruar prej tij gjithsej 100 % (njqind perqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, dhe Blerësi ka pranuar të blejë kuotën e zotëruar dhe të ofruar nga Shitësi në Shoqëri;
- C. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pas miratimit përkatës nga Asambleja e Ortakeve sipas vendimit bashkëlidhur, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Objekti

Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi kalon në pronësi të Blerësit dhe Blerësit fiton pronësi mbi 100% (njqind perqind) të kapitalit të shoqërisë "ECW" Shpk, kundrejt cmimit të shitjes të caktuar në këtë Kontratë.

Neni 2
Çmimi



A2025053950367848141

Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të Shoqërisë është 5.000 leke (pese mijë leke). Çmimi i shitjes është paguar nga blerësi të shitësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate dhe palet deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim lidhur me mënyrën e pagesës.

Neni 3

Deklarimet dhe garancite

Shitësi deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron kuotën që do të transferohet sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'a transferuar kete kuote dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Shitësi. Shitësi përgjigjet për detyrimet që Shoqëria mund të ketë ndaj të tretëve përfshirë detyrimet tatimore përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Blerësi deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Blerësi ka tagra të plota për të pranuar kuotën nga Shitësi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Blerësi.

Neni 4

Transferimi i të drejtave mbi kuotat

Pronësia mbi kuotën e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Z. Erland Reka behet ortak i vetëm zoterues i 100% të kapitalit të shoqërisë, ndërsa Z. Greg Xhillari largohet nga shoqëria. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotën e zotëruara në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Deklarime dhe garanci

5.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

- a. Shitësi është zotëruesi i vetëm i Kuotës së Shoqërisë dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra të plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij.
- b. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
- c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirisht e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate. Shitësi ka të drejtë të shesë dhe t'i transferojë Kuotën Blerësit sipas kësaj Kontrate, Blerësi fiton të drejtat e plota e të pakufizuara të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
- d. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
- e. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi garanton Blerësin se do t'i sigurojë atij kontrollin efektiv të Shoqërisë në përputhje me të drejtat që rezultojnë nga zotërimi i Kuotës,
- f. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhena sipas kësaj Kontrate janë të verteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

5.2 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a. Blerësi ka tagra të plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.



A2025053950367848141

- c. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhena sipas kësaj Kontrate janë të verteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

5.3 Palet konfirmojnë se detyrimi i Blerësit për pagimin e çmimit të shitjes është përmbushur përpara lidhjes së Kontratës.

Neni 6
Dispozita të fundit



- 6.1 Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
- 6.2 Çdo kusht / klauzole apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 6.3 Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 6.4 Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 6.5 Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrates i bashkelidhen kopje të dokumenteve të identifikimit dhe përfaqësimit të Palëve dhe Aneksi A (Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë) dhe Aneksi B (Vendimi i Asamblese së Ortakeve të Shoqërisë për miratimin e transferimit të Kuotës).

Kjo Kontratë hartohet në gjuhën Shqipe në 4 (kater) kopje origjinale. Kjo Kontratë pasi iu lexua Palëve me zë të lartë e të qartë, nga unë noter, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për gjithë efektet që passjell.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Greg Xhillari

BLERES

Erland Reka

Noter

Julian Zhelegu